



KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOOPREDELJENJE D.O.

PRISHTINA



26 NOV 2018

Kompania Rajonale Ujësjetlësi “Prishtina” Sh.A.

KODI I ETIKËS DHE MIRËSJELLJES

Prishtinë, 2018

Bordi i Drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" Sh.A., Prishtinë, me datë 20.11.2018 miratoj dhe publikoj:

KODIN E ETIKËS DHE MIRËSJELLJES

1. HYRJE

- 1.1 Ky Kod i Etikës dhe Mirësjelljes është përpiluar dhe është në përputhshmëri me Statutin e KRU "Prishtina" Sh.A., Nenin 35.1 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 03/L-087) dhe plotësim ndryshim të Ligjit Nr. 04/L-111, të datës 17.05.2012 dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-111 të datës 24.04.2015 (këtu e tutje "Kodi").
- 1.2 Përveç nëse përcaktohet ndryshe, kushtet e këtij Kodi të Etikës do të vlejnjë për të gjithë Punëtorët, Zyrtarët, Menaxherët dhe Zyrtarët e Lartë, me marrëdhënie të përhershme apo të përkohshme të punës në KRU "Prishtina" sh.a.
- 1.3 KRU "Prishtina" sh.a., ruan të drejtën ekskluzive për të modifikuar, hequr, dhe interpretuar çdo pjesë të Kodit ashtu siç mund të vlerësojë të arsyeshëm herë pas here dhe siç kërkohet pas ndryshimeve të ligjit në fuqi. Sidoqoftë, çfarëdo ndryshimi në Kod pajtetër të jetë me shkrim i lejuar nga Kryeshefi Ekzekutiv.
- 1.4 Në këtë Kod:
 - (a) Referimet si "KRU" apo "Kompania", do të nënkuptohen që i referohen Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit – "Prishtina" Sh.A. dhe të gjitha Njësive që janë në kuader të Kompanisë, apo inkorporohen me vonë.
 - (b) Referimet si "punëtori" apo "punëtorët" do të nënkuptohen që i referohen të gjithë Punëtorëve, Zyrtarëve, Menaxherëve dhe Zyrtarëve të Lartë dhe të përkohshëm të KRU-së, dhe të çdo entiteti publik trashëgues që ka në pronësi dhe kryen veprimtaritë e ofrimit të shërbimeve që Kompania ka për aktivitet.
 - (c) Referimet si "Kodi", apo "Kodi i Sjelljes", apo "Kodi i Etikës" do të nënkuptohen që i referohen përmbajtjes së këtij dokumenti dhe shtojcave të tij, dhe ndonjë ndryshimi apo amendamenti që del nga kjo.
 - (d) Referimet si "Ligji në fuqi" do të nënkuptohet si çdo ligj në fuqi në Kosovë sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/5. Në bazë të kësaj, një referim i veçantë duhet t'i bëhet Ligjit Themelor të Punës (Ligji Nr. 03/L-212) siç ndryshohet apo ri-dekretohet herë pas here.
 - (e) Referimet për Kryeshefin Ekzekutiv do të nënkuptojnë personin që mban pozitën e shefit ekzekutiv brenda Kompanisë (si në aspektin e përhershëm apo të përkohshëm) sipas Statutit të KRU-së dhe Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 03/L-087 dhe plotësim ndryshim të Ligjit Nr. 04/L-111, të datës 17.05.2012 dhe Ligji për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-111 të datës 24.04.2015, siç është aprovuar me të drejtë dhe i caktuar nga Bordi i Drejtorëve të Kompanisë.

- 1.1 Opinioni-konsumatorët kanë të drejtë të kërkojnë që të gjithë zyrtarët-të punësuarit në KRU "Prishtinë" Sh.A., të jenë të ndershëm, të paanshëm dhe profesional në kryerjen e punëve të tyre.
- 1.2 Për ta ruajtur mirëbesimin nga opinion-konsumatorët është me rëndësi që zyrtarët -të punësuarit në Kompani ti përmbushin standardet më të larta gjatë mardhënieve të tyre me publikun-konsumatorët, afaristët dhe zyrtarët të tjerë.
- 1.3 Për ruajtjen e kësaj ndershmërie në KRU "Prishtinë" Sh.A. është e nevojshme miratimi i Kodit gjithëpërfshijës i Mirësjelljes, që në mënyrë praktike dhe të kjashtë përcakton standardet e sjelljes dhe etikën që pritet të demonstrohet nga të gjithë të punësuarit.
- 1.4 Respektimi i Kodit të Mirësjelljes është obligim sipas kontrates së punës -gjegjësisht përgjegjësisë disiplinore të të punësuarve në KRU "Prishtinë" Sh.A. si pjesë e Rregullores së mardhënies së punës dhe aneksit të saj, Përgjegjësia disiplinore.
- 1.5 Me Kodin e Mirësjelljes, të punësuarit do të njoftohen nëpërmjet të shpalljes së saj në tabelën e shpalljeve dhe nëpërmjet të Menaxherve të Departamenteve.
- 1.6 Për të gjithë të punësuarit që dyshohet të kenë shkelë Kodin e Mirësjelljes do ti nënshtrohen masave disiplinore sipas procedurës disiplinore të KRU "Prishtinë" Sh.A. - Prishtinë.
- 1.7 Menaxheret e Departamenteve përkatëse duhet të jenë të vetëdijshëm se mund të konsiderohen neglizhent nëse në fushën e vetë të përgjegjësisë ndodhën parregullësi dhe të cilat ata i kanë vrejt dhe nuk i kanë paraqitur ato parregullësi dhe ndërmarrjen e masave ndaj atyre.

2. Qëllimi

- 2.1 Nga ky Kod i Mirësjelljes kërkohet që të përshkruaj në mënyrë praktike dhe të kjashtë standardet e mënyrës së sjelljes dhe etikën që pritet të tregohet nga të gjithë të punësuarit në Kompani.
- 2.2 Involvim i të punësuarve në shkeljen e Kodit të Mirësjelljes mund të rezultoj me masa disiplinore, duke përfshirë edhe ndërprerjen e kontratës së punës.
- 2.3 Ligji i konsideron vepra penale, kur një i punësuar është involvuar në mito apo keqpërdorim të detyrës zyrtare. Kjo do të thotë, po qëse i punësuar për përfitim të vetin e duke e dëmtuar shumë Kompaninë kryen ndonjë veprim që për atë veprim nga tjetri merr mito apo keqpërdor mjetet e Kompanisë

3. Përgjegjësia personale

- 3.1 Të gjithë të punësuarit duhet të pranojnë përgjegjësinë personale për t'iu përshtatur Kodit aktual të Mirësjelljes dhe veçanërisht Zyrtarët e Lartë, por edhe të tjerët duhet të

- pëmbushin me kujdes, zell, profesionalizëm dhe ndërshtimeri detyrat e punës që i janë përshkruar në përshkrimin e punëve dhe detyrave të punës dhe ato çfarë parashet Kodi.
- 3.2 Të mundohen të arrijnë standarde të larta etike, ta lexojnë dhe t'i pëmbahën Kodit të Mirësjellëjes dhe t'i kuptojnë pasojat në rast të shkeljes së tij.
- 3.3 T'i trajtojnë kolegët dhe pjesëtarët e shoqërisë me mirësjellëje dhe të jenë të ndërgjegjshëm ndaj të drejtave, detyrave të tyre.
- 3.4 T'i shmangën shpërdorimit apo përdorimit të tepruar të pasurisë dhe mjeteve të Kompanisë.
- 3.5 Të mos të përfitojnë në mënyrë të padrejtë dhe jo ligjore. Zyrtarët e Kompanisë të cilët bëjnë shkelje të ligjit dhe Rregulloreve të Kompanisë konsiderohen shkelje të rënda.
- 3.6 Të punuarit të cilët bëjnë mashtrime, marrje të mitos apo keqpërdorime të mjeteve të ndryshme të Kompanisë, apo dëmtojnë në mënyrë të vetëdijshme konsumatorët duke mos i paraqitur pagesat e tyre ashtu që konsumatori ka bërë pagesën të punësuarit dhe ato mjete nuk i ka dorëzuar ashtu siç duhet të regjistrohen në kontabilitetin e Kompanisë ata do t'i nenshtrohen përgjegjësisë disiplinore dhe penale. Posa të merren informata lidhur me këto apo të ngjajshme Kryeshefi Ekzekutiv apo Zyrtarët përkatës e paraqet rastin dhe ndaj të punësuarit inicohet procedura disiplinore adekuate sipas peshës.

4. Ankesat kundër Kompanisë

- 4.1 Është me rëndësi që opinioni të ketë besim në ndershmëri të Kompanisë dhe ndaj zyrtarve të saj.

5. Marrëdhëniet me publikun

- 5.1 Opinioni pret që marrëdhëniet e tyre me Kompaninë të jenë të ndershme, profesionale dhe të besueshme, prandaj zyrtarët e Kompanisë duhet të kenë qëndrim të sjellshëm profesional dhe të jenë në shërbim të tyre, gjegjësisht në shërbim të shoqërisë.
- 5.2 Zyrtarët e Kompanisë duhet të përdorin të gjitha mjetet e arsyeshme për të ndihmuar konsumatorët për t'i plotësuar nevojat e tyre, por duhet për të pas për bazë edhe sinqeritetin dhe obligimet e konsumatorëve ndaj Kompanisë. Kompania duhet t'u përbahet rregullave të ARRU-së.
- 5.3 Në shumicën e rasteve Opinioni ka të drejt ta dijë se me kënd ka të bëjë. Andaj zyrtarët e Kompanisë duhet të prezantohen pra ta prezantojnë vetvetën gjatë bisedave telefonike, ndërsa poqëse kanë kontakt direkt me publikun duhet të prezantojnë kartelën e identifikimit.

6. Pranimi i dhuratave, shpërblimeve të tjera

- 6.1 Me rastin e kontakteve të ndryshme që mbajnë zyrtarët e Kompanisë me njëzë të jashtëm në emër të Kompanisë, zyrtarët e Kompanisë duhet t'u japin atyre me kupt se nuk dëshirojnë të hyjnë në mito apo korrupsion, prandaj ofrimi i dhuratave, shpërblimeve etj. nuk duhet pranuar në atë mënyrë që t'u jep atyre me kuptuar se këto kanë ndikim në marrjen e vendimeve ashtu siç dëshirojnë ata, por duhet kuptuar se në Kompani zbatohet rregulla apo ligji në fuqi duke respektuar edhe ligjin e Anti Korrupsionit.

- 6.2 Dhuratat me vlerë të vogël nuk duhet ta kenë këtë kuptim, por të përcaktuar me Ligj.
- 6.3 Dhuratat me vlerë mesatare apo me vlerë të madhe nuk duhet kuptuar personale por në emër të Kompanisë, por kjo dhuratë nuk duhet të ndikon në marrjen e vendimit në kundërshtim me ligjin apo rregullat e Kompanisë.

7. Zyrtari i Prokurimit

- 7.1 Zyrtarët e Prokurimit duhet të jenë shumë të kujdesshëm për të mos ju ekspozuar akuzave për realizimin e padrejt të blerjeve. Si rezultat i kësaj ata nuk duhet të pranojnë dhurata apo ndonjë mikëpritje nga furnizuesit ekzistues apo të mundshëm. Çdo perfitim i kësaj lloji duhet t'i takon Kompanisë e jo ta përvetson vetë.
- 7.2 Lidhjet personale të zyrtarëve të Kompanisë.
- 7.3 Zyrtarët e Kompanisë nuk duhet të shfrytëzojnë lidhjet e tyre me personat e jashtëm dhe ato lidhje të ndikojnë në marrjen e vendimeve në favor të personave që kanë lidhje me zyrtarët e Kompanisë, sepse në këtë mënyrë realizohen interesat e përhashkëta në mes të personave që janë në lidhje .
- 7.4 Kontratat biznesore nuk mund të lidhen as t'u jipen atyre që një nga partnerët është zyrtar i Kompanisë apo anëtarë i ngushtë i familjes së zyrtarit të Kompanisë.

9. Aktivitetet politike

- 9.1 Të punësuarit në Kompaninë KRU "Prishtina" Sh.A., mund t'i përkasin partive politike dhe organizatave të tjera, apo të abstenojnë nga ato, por ata punë dhe aktivitet primar duhet të kenë punët dhe detyrat e punës në Kompani.

10. Pranimi dhe ruajtja e parave zyrtare

- 10.1 Në kushte normale asnjë person tjetër nuk mundë të pranojë para të dedikuara për Kompaninë përveç atyre që në përshkrim të punëve dhe detyrve të punës parashihet ashtu, poqëse paraqitet nevojë atëherë personi që e bënë këtë duhet të ketë autorizim në formë të shkruar të dhënë nga Kryeshefi Ekzekutiv.
- 10.2 Për çdo pagesë që bëhet për të, lëshohet veritetimi mbi pagesën që një kopje i dorzohet pagesit e një kopje ruhet në Kompani.
- 10.3 Të punësuarit kompetent që bëjnë pagesa, pra pranojnë para nga konsumatorët apo pagesa tjera, kanë përgjegjësi që t'u shmangen sjelljeve që japin shkas për kritika se parat e tyre – të konsumatorëve përdorën për përfitime personale. Sjelljet e tilla konsiderohen shkelje serioze të disiplinës së punës dhe ata do të përballen me masa disiplinore dhe penale, varësisht nga pesha e shkeljes.

11. Konfidencialiteti, zbulimi i informatave zyrtare

- 11.1 Të gjithë të punësuarit kanë për detyrë që pa autorizim të mos japin informata të cilat trajtojnë çështje sekrete të Kompanisë.

12. Përdorimi i pronës dhe shërbimeve zyrtare të Kompanisë

- 12.1 Përdorimi i pronës së Kompanisë pa autorizim për përfitime personale janë të ndaluara.
- 12.2 Për përdorimin dhe mirëmbajtjen e veturave dhe automjeteve tjera të Kompanisë aplikohën rregulla specifike.
Të punësuarit të cilët janë të caktuar që të vozitin automjetet e Kompanisë, duhet të kenë patent shoferin valid dhe të kenë autorizimin nga personi i caktuar i Kompanisë, për përdorimin e automjetit.
- 12.3 Udhëtarët e pa autorizuar, gjegjësisht ata që nuk janë të punësuar në Kompani nuk guxojn të bartën me veturat e Kompanisë, por për këtë paraprakisht duhet të ketë lejen apo urdhëresën nga Kryesheli Ekzekutiv, apo personi tjetër i autorizuar për dhënjën e lejes.
- 12.4 Veturat e Kompanisë nuk duhet të përdorën për të siguruar transportin nga shtëpia në punë dhe anasjelltas për të punësuarit e kompanisë, përveç atyre që Bordi i Drejtorëve ua lejon me vendim (Zzyrtarëve të Lartë) dhe atyre që Kryesheli Ekzekutiv u lejon me urdhër të veçantë.
- 12.5 Të gjithë të punësuarit kanë të drejtë për ambient të sigurt dhe të shëndetshëm pa diskriminim.

12. Përdorimi i telefonave fiks, mobil dhe internet

- 12.1 Të punësuarit e kompanisë telefonat zyrtarë mund të përdorin zyrtarisht duke u munduar që bisedat të jenë të shkurta në minimum, ashtu dhe interneti të përdoret sidomos për ato vënde të punës ku është e domosdoshme përdorimi i internetit për komunikime zyrtare e në minimum për ato private.

13. Përmbledhje

- 13.1 Opinioni-konsumatorët kanë të drejtë të presin nga zyrtarët e Kompanisë që të jenë të ndershëm, të paanshëm dhe profesional. Për të ruajtur mirëbesimin e opinionit është me rëndësi që zyrtarët e Kompanisë t'i përmbahën standardeve më të larta të ndershmërisë gjatë punës së tyre me opinionin, gjegjësisht me konsumatorët.
- 13.2 Për tu zbatuar ky Kod, çdo i punësuar në Kompani duhet të kryej detyrat e veta me kujdes, vullnet, profesionalizëm dhe ndërshtmeri, si dhe gjatë gjithë kohës që punon të orvatet që ta ngritin reputacionin e Kompanisë.
- 13.3 Përsnat përgjegjes në Kompani duhet të ndërmarrin veprimet e duhura kur i punësuarit gjatë kryerjes së punës së vetë bëjnë shkeljen e këtij Kodi dhe shkel disiplinën e punës, andaj përsnat përgjegjës duhet të marrin veprimet e duhura dhe rastet e tilla t'i paraqesin para organeve të Kompanisë dhe ndaj tyre të ndërmerrin masat adekuate disiplinore.
- 13.4 Me Kodin e mirësjelljes të punësuarit do të njihohen nëpërmjet të menaxhervë të departamenteve duke ua komentue aty edhe
- 13.5 Shpallja publike e Kodit të Mirësjelljes në tabelën e shpalljes në të gjitha Njësitë Operative të Kompanisë.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve
Amir Gashi